



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401749/3

Tiranë ____/____/2014

Lenda: *Rekomandojme njohjen e periudhës 1994-1999 dhe 2000-2003 si i vetpunësuar në bujqësi si dhe vazhdimin e së drejtës për përfitimin e pensionit të pleqërisë shtetasit B.Gj*

Drejtuar: **Z. Miranda KOKA**
Drejtore e Drejtorisë Rajonale
të Sigurimeve Shoqërore

D U R R Ë S

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi B.Gj, me objekt: mbylljen e pensionit të pleqërisë, për arsye të mosnjohjes së sigurimit si i vetpunësuar në bujqësi për periudhën 1994-1999 dhe 2000-2003.

Sipas shpjegime të parashtruara në ankesë dhe dokumentacionit që disponojmë, konstatojmë si më poshtë:

Shtetasi B.Gj është banor i qytetit të Durrësit, i cili më datë 11.09.1997 është transferuar në këtë qytet nga Komuna Velçan Pogradec.

Më datë 12.04.2013 ka përfituar pension të plotë pleqërie në kushtet e kategorisë së tretë, me një vjetërsi të përgjithshme pune prej 38 vjet e 5 muaj, nga të cilat 16 vjet e 7 muaj punë në shtet.

Ky shtetas është siguruar si i vetpunësuar në bujqësi në vitet 1993-2003, por periudha 1994-1999 dhe 2000-2003, aktualisht nuk i njihen dhe pensioni i tij është mbyllur. Këto vite të sigurimit ankuesi i vërteton me anë të dy vërtetimeve, për të vetpunësuarit në bujqësi. Njëra nga vërtetimet, e lëshuar nga ALSSH-ja Pogradec, mban datën 05.03.2003, me anë të së cilës vërtetohet se ankuesi ka derdhur kontribute si bujk privat për periudhën 01.01.1993-01.12.1993 dhe 01.01.2000 – 12.04.2003. Ndërsa vërtetimi tjetër, lëshuar nga DRSSH-ja Durrës, më datë 30.04.2003, me anë të së cilës vërtetohet se ka derdhur kontribute si bujk privat për periudhën 01.01.1994-31.12.1999.

Rezulton se sipas vërtetimit të lëshuar nga Komuna Velçan, nr.27 prot. datë 23.05.2014, familja e z.B.Gj është trajtuar me tokë bujqësore në fshatin Laktesh. Sipas Aktit të marrjes së tokës në pronësi, datë 18.07.1992, në mbështetje të Ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 "Për tokën", familjes së z.B.Gj nga fshati Laktash, i jepet në pronësi tokë, gjithsej 8512m².

Me Vendimin nr.7036 datë 06.10.2014 të Degës së Përfitimeve pranë drejtorisë suaj, shtetasit B.Gj i është mbyllur pensioni i pleqërisë, për arsye se kur është siguruar si bujk privat për vitet 1994-1999 nuk ka patur tokë në Durrës si dhe për vitet 2000-2003 është siguruar në Pogradec, duke qenë me banim në Durrës.

Ju bëjmë me dije se, institucioni i Avokatit të Popullit në vitin 2009, pas shqyrtimit të ankesave të shtetasve të ndryshëm për mosnjohjen e sigurimit si të vetpunësuar në bujqësi deri në vitin 2004, në kushtet e ndryshimit të vendbanimit, i është drejtuar me rekomandim Ministrisë së Financave për ***njohjen e periudhës së sigurimit të të vetpunësuarve në bujqësi deri në vitin 2004 si dhe kthimin e shumës së derdhur të kontributeve si të vetpunësuar në bujqësi pas vitit 2004 për personat që kanë ndërruar vendbanimin e tyre.***

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Financave, miratoi Vendimin nr.1206 datë 11.12.2009 "Për një shtesë e ndryshim në VKM nr.1114 datë 30.07.2008, ku sipas pikes 6/1 njihen periudha sigurimi periudhat nga data 01.10.1993 deri më datë 01.05.2004 për të cilat të vetpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës. Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr.177 datë 21.12.2009.

Pra, siç shihet, VKM-ja e sipërcituar ua njeh të gjithë shtetasve të drejtën e njohjes së periudhës së sigurimit si të vetpunësuar në bujqësi deri në vitin 2004, pavarësisht vendbanimit të tyre.

Në këto kushte, shtetasit Bexhet Gjona, duhet t'i njihen periudhat 1994-1999 dhe 2000-2003, si periudha të sigurimit si bujk privat, pasi tokën e ka patur në komunën Velçan, Pogradec dhe që nga viti 1997 është banues në qytetin e Durrësit.

Për sa më sipër, me qëllim që ankuesi të përfitojë të drejtat e tij ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike";

REKOMANDOJMË:

Njohjen e periudhës 1994-1999 dhe 2000-2003 si i vetpunësuar në bujqësi si dhe vazhdimin e së drejtës për përfitimin e pensionit të pleqërisë, shtetasit B.Gj.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se;

"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t'a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ",

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI